



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:247924
Datë: 27.06.2024
Numri i dokumentit: 05876412

Ac.nr.8735/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Enes Mehmeti, dhe Arsim Hamzaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.G. nga Mitrovica, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.R., avokat në Mitrovicë, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës, Sh.A., me seli në Prishtinë, e përfaqësuar sipas autorizimit nga Sh.M., lidhur me çështjen kontestuese kompensim i pagave jubilarë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.761/2019, të datës 18.10.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e themeltë ankesa e të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A, me seli në Prishtinë, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.761/2019, i datës 18.10.2022, dhe gjykohet si vijon: **REFUZOHET** e pabazuar kërkesëpadia e paditësit S.G. nga Mitrovica, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A, me seli në Prishtinë, që paditësit, në emër të tri pagave për shpërblimin jubilar, t'ia paguaj shumën prej 2,253.00 €, me kamatë në lartësi prej 8 %, nga dita e paraqitjes së padisë e gjerë në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e atakuar, C.nr.761/2019, të datës 18.10.2022, ka vendosur si vijon: “I. APROVOHET NË TËRËSI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit S.G. nga Mitrovica, ashtu që DETYROHET e paditura Korporata Energjetike e Kosovës, Sh.A. (KEK), me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të tri pagave për shpërblimin jubilar, t'ia paguaj shumën prej 2,253.00 €, me kamatë në lartësi prej 8

%, e cila do të llogaritet nga data e nxjerrjes së Aktgjykimit gjegjësisht prej datës 18.10.2022, e gjerë në pagesën definitive; II. DETYROHET e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumë prej 235.00 €. Të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim”.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit, ta aprovoi ankesën e të paditurës si të bazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar të ndryshohet me refuzim të kërkesëpadiisë si të pabazuar.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur paditësi përmes të autorizuarit të tij, me propozim që ankesa e të paditurës të refuzohet si e pa bazuar ndërsa aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 (pika e) dhe 201 (pika d), të Ligjit nr.3/L-006 për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton së paditësi S.G. nga Mitrovica, përmes përfaqësuesit të autorizuar, më datë 15.03.2019, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ka paraqitur padi kundër të paditurës Korporatës Energjetike e Kosovës Sh.A, me seli në Prishtinë, me kërkesë për pagesën e tri pagave në emër të shpërblimit jubilar. Në padi ka parashtruar së paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura deri me datë 29.06.2015, kur të njëjtit i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. Ka theksuar së paditësi ka punuar pa ndërprerje tek e paditura në kohëzgjatje prej 43 vite, 7 muaj dhe 8 ditë, dhe në këtë rast të njëjtit i takojnë tri paga në emër të shpërblimit jubilar, bazuar në dispozitën e nenit 52 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e Kosovës, të nënshkruar me datë 18.03.2014, me efekt veprimi nga data 01.01.2015. Në seancën përgatitore të datës 05.10.2022, e ka bërë precizimin e kërkesëpadiisë duke i propozuar gjykatës që të detyrohet e paditura që paditësit, në emër të shpërblimit jubilar t'ia paguaj shumën prej 3 (tri) paga mujore në shumë prej 2,253.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e ushtrimit të padisë gjeri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm, si dhe t'i paguaj shpenzimet e procedurës.

E paditura përmes përgjigjes në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka kontestuar kërkesëpadiinë e paditësit dhe i ka propozuar gjykatës që të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe administrimit të provave, ka marrë aktgjykimin e atakuar C.nr.761/2019, të datës 18.10.2022, me te cilin aktgjykim e ka aprovuar në tërësi të bazuar kërkesëpadiinë e paditësit, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata ka konstatuar së në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune me të paditurën nga janari i vitit 1972, e deri në pensionim e tij, gjegjësisht datë 29.06.2015, dhe se nga e tërë kjo periudhë, ka realizuar 43 vite, 7 muaj e 8 ditë përvojë punë tek e paditura. Kjo u provua edhe në bazë të Kartelës së punëtorit të lëshuar nga e paditura, e cila kartelë, në pjesën hyrëse të saj, kishte të listuar edhe vitet e përvojës së punës së paditësit tek e paditura, si dhe kopja e librezës së punës së paditësit. Nuk ishte kontestuese se paditësi është pensionuar tek e paditura, sipas Vendimit të të paditurës me nr. 1148, i datës 22.06.2015, pasi që i njëjti kishte arritur moshën e pensionimit. Nuk ishte kontestuese as lartësia e pagës që paditësi ka realizuar tek e paditura, megjithatë kjo u provua edhe nga lista e pagës për muajin qershor 2015, si dhe nga Vendimi i të paditurës me nr. 1148, të datës 22.06.2015, me të cilin paditësit i janë njohur tri paga përcjellëse me rastin e pensionimit, ku paditësit i është njohur e drejta në kompensim të tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, që i bie secila në lartësi prej 751.00 €. Ndërsa çështje kryesore kontestuese mes palëve ndërgjyqëse është nëse paditësit i takon e drejta për kompensimin në emër të shpërblimit për tri paga jubilarë. Nga provat e administruara si më lartë, gjykata gjeti se paditësi kishte punuar tek e paditura për më rreth 43 vite, dhe të njëjtit nuk i janë paguar pagesat për shpërblim jubilar në vlerë të tri pagave, të parapara me nenin 52 par. 1 të MPKK, ku parashihet se *“I punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: pika 1.3. për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij”*. Mos pagesën e këtyre pagave edhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor e ka pohuar edhe e paditura, duke pretenduar se një e drejtë e tillë nuk i takon paditësit, për shkak së në kohën e arritjes së përvojës 30 vjeçare nga paditësi, nuk ishte në fuqi Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës. Ndërkohë që paditësi, sipas vlerësimit të të paditurës, nuk i plotëson as kriteret e përcaktuara me vendimet e brendshme të të paditurës për kompensimin e pagave jubilarë. Gjykata në bazë të provave të administruara në këtë shqyrtim, vërtetoi faktin së paditësi gjatë kohës sa ishte në marrëdhënie pune tek e paditura kishte realizuar pagë bazë në shumë prej 751.00 euro, fakt ky i provuar me listën e pagave të paditësit, ndërsa duke llogaritur për tri paga, rezultoi shuma prej 2,253.00 €,aq sa ishte edhe vlera e kërkesëpadsisë së paditësit. Gjykata e shkallës së parë duke ju referuar MPKK, të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës dhe Odës Ekonomike të Kosovës, dispozitat e së cilës aplikohen në tërë territorin e Kosovës, ku në nenin 52 është paraparë e drejta e punëtorit në shpërblim jubilar, ka gjetur se e njëjta është e aplikueshme në rastin konkret dhe se e paditura ka pasur detyrim që në kohën e arritjes së kushtit, paditësit t’ia paguaj tre paga në emër të shpërblimit jubilar, ngase ky detyrim rrjedh nga neni 52 i MPKK-së, dhe ka vendosur që ta detyroj të paditurën që paditësit t’ia kompensoj shumën si në dispozitivit të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata, pretendimet e të paditurës lidhur me parashkrim i gjen si të pa bazuara dhe të pa mbështetura në asnjë normë ligjore të aplikueshme. Gjykata vë në dukje se paditësi ka parashtruar padinë brenda afatit ligjor të paraparë sipas nenit 87 të Ligjit të punës. E paditura sipas nenit 52 të MPKK, ka pasur për detyrim që brenda afatit prej 30 ditëve me rastin e pensionimit t’ia paguaj pagat jubilarë, ashtu siç ka vepruar me pagat përcjellëse në pension. Duke qenë se një gjë e tillë nuk është realizuar, paditësi ka ushtruar padi në gjykatë. Gjykata vlerëson se pretendimi për parashkrim të kërkesës nuk qëndron, ngase përderisa ka qenë në fuqi MPKK, ka ekzistuar detyrimi i të paditurës për pagesën e shpërblimit jubilar.

Për mënyrën e vendosjes përveç dispozitave të MPKK-së, si bazë ligjore i është referuar edhe nenit 245 të LMD-së. Vendimin për kamatën e ka bazuar në nenin 382 të LMD-së, ndërsa vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore e ka marrë duke u mbështetur në dispozitën e nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht prandaj aktgjykimi është ndryshuar.

Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të dispozitës së nenit 195 paragrafi 1 pika (e) e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika (d) e LPK-së, sepse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale.

Nga shkresat e lëndës rezulton së nuk është kontestues fakti që paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura që nga viti 1972, e deri në pensionim e tij, gjegjësisht datë 29.06.2015, dhe se nga e tërë kjo periudhë, ka realizuar 43 vite, 7 muaj e 8 ditë përvojë punë tek e paditura, i cili fakt është vërtetuar edhe në bazë të kartelës së punëtorit të lëshuar nga e paditura me datë 02.09.2020.

Megjithatë, paditësi bazën ligjore të kërkesëpadiës e ka mbështetur në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës, të lidhur dhe nënshkruar nga Organizatat e Punëdhënësve (Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit), Organizatat e të Punësuarve (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës) dhe Qeveria e Republikës së Kosovës. Dispozita nga neni 82 e kësaj Marrëveshje parasheh që *“Kjo Marrëveshje e Përgjithshme Kolektive e Kosovës (MPKK) e nënshkruar nga Partnerët në Këshillin Ekonomiko – Social të Kosovës, hyn në fuqi nga data 01.01.2015”*. Në anën tjetër, dispozita e nenit 90 par.4 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, parasheh që *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet”*. Ndërsa në bazë të nenit 52 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës është paraparë së *“I punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: 1.1.për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një paga mujore të tij; 1.2.për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij; 1.3.për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij. 2.Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. 3.Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”*.

Gjykata e Apelit, vlerëson së Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, ka qenë në fuqi nga data 01.01.2015, deri me datë 31.12.2017, kjo duke u bazuar në dispozitën e nenit 90 par. 4 të Ligjit të Punës, ku është paraparë se Marrëveshja Kolektive zgjatë jo me shumë se tri vite.

Në rastin konkret është vërtetuar së paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura që nga viti 1972, dhe së është vërtetuar së i njëjti deri me datë 29.06.2015, kur i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit 65 vite, ka arritur 43 vite, 7 muaj, dhe 8 ditë përvojë pune, dhe nga kjo rezulton së i njëjti vitin jubilar prej 30 vite përvojë punë tek e paditura e ka arritur në vitin 2002, pra para hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, në të cilën paditësi e bazon kërkesën.

Andaj, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar pasi që paditësi nuk ka pasur vit jubilar 10, 20 apo 30 vite, ashtu siç përcaktohet me nenin 52, gjatë periudhës sa ka qenë në fuqi MPKK, duke qenë së i njëjti vitin jubilar prej 30 viteve e ka arritur në vitin 2002, dhe me asnjë dispozitë të kësaj kontrate nuk është paraparë efekti prapaveprues, që do të thotë se e njëjta nuk gjen zbatim për rastet kur të punësuarit vitet jubilarë prej 10, 20, 30 viteve i kanë plotësuar para hyrjes në fuqi të Marrëveshjes Kolektive, siç është rasti i paditësit. Dispozitat e cituara nga gjykata e shkallës së parë do të mund të gjenin zbatim vetëm nëse Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës do të ishte në fuqi në momentin e plotësimit të kushtit për kompensimin e shpërblimit jubilar, mirëpo meqenëse e njëjta nuk ka qenë në fuqi, pala e paditur nuk i detyrohet palës paditëse në asnjë pagesë apo borxh siç i referohet gjykata e shkallës së parë. Për këto arsye, Gjykata e Apelit vendosi që aktgjykimi i atakuar duhet të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësit duhet të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata e Apelit, vendimin për shpenzimet e procedurës, që secila palë t'i bartë shpenzimet e saj të procedurës, e ka bazuar në kuptim të nenit 450 të LPK-së, duke qenë së kërkesëpadia e paditësit është refuzuar si e pabazuar, ndërsa e paditura nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore.

Nga të cekurat më lartë, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e në bazë të nenit 195.1 pika e) e lidhur me nenin 201 par.1 pika d) të LPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.8735/2022, datë 27.06.2024

Kryetari i kolegjit, Gjyqtari
Hysni Bardheci